



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2423/2 prot

Datë 04.10.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME.

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “*M. Lezha*” SHPK dhe operatorit ekonomik “Murati D” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*,” me nr REF-79080-09-06-2023 me objekt “*Blerje pajisje mobilerie, Shkolla fillore ”Myrteza Sala” Bilisht, Devoll*” me fond limit 4,298,177 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18.09.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Devoll.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Klame” SHPK me NIPT: K21518003F
Adresa: Rruga “Gani Kryeziu”, Nr. 23, Kati i dytë, Njësia Administrative 11, Kodër Kamëz, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Devoll
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “*M. Lezha*” SHPK me NIPT: J76504013C
Adresa: Zona Industriale, Rruga “Lëvizja e Postribës”, nr pasurie 11/200, zona kadastrale 8592, Shkodër.
- Operatori ekonomik “Murati D” SHPK me NIPT: K42003004T
Adresa: Rruga Kavajes, Ish- Kombinati Ushqimor, Godine 1- kateshe, Tiranë.

Në datën 03.10.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur në mënyrë shkresore ankesa me nr. 2423, protokolluar me datë 03.10.2023 e operatorit ekonomik “Klame” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar,” me nr REF-79080-09-06-2023 me objekt “Blerje pajisje mobilerie, Shkolla fillore ”Myrteza Sala” Bilisht, Devoll” me fond limit 4,298,177 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18.09.2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Devoll.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “M. Lezha” SHPK dhe operatorit ekonomik “Murati D” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

-Komisioni i prokurimit Publik Publikon kriteret mbi te cilat ankimuesi pretendon se operatori ekonomik “M. Lezha” SHPK nuk i plotëson:

Në ankesë ngrihen pretendime se oferta e operatori ekonomik “M. Lezha” SHPK, është ofertë anomalisht e ulët bazuar në nenin 93 të LPP.

-Komisioni i prokurimit Publik Publikon kriteret mbi te cilat ankimuesi pretendon se operatori ekonomik “Murati D” SHPK nuk i plotëson:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për pervojën e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të kontrates ,

Për të vërtetuar pervojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për pervojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 04.10.2023

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro